



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



PROCESVERBAL

Mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më 20.10.2021, me fillim në ora 10.00. Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit **Afrim Dina**.

Kryesuesi – Fillimisht më lejoni të përshëndes, nënkryetarin **Fatmir Iska**, te nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, drejtorët e drejtorive, përfaqësues të mediave dhe të gjithë ju të pranishëm.

Të nderuar anëtarë të KPF-së, për këtë mbledhje propozoj këtë :

REND DITE

1. **Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
2. **Shqyrtimi i Raportit financiar për periudhën Janar – Shtator 2021;**
3. **Informatë për menaxhimin e mbeturinave për vitin 2021;**
4. **Të ndryshme.**

Të nderuar kolegë, e qesim në votim rendin e ditës. Konstatoj se unanimisht aprovohet rendi i ditës. Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

A ka dikush diçka sa i përket procesverbalit, nëse e jo e qesim në votim. Konstatoj se unanimisht aprovohet pika e parë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Shqyrtimi i Raportit Financiar për periudhën Janar – Shtator 2021.

Afrim Limani – Përshëndetje për ju kryesues, nënkryetarin dhe gjithë anëtarët e KPF-së. Raporti financiar 9 – mujor është i përbërë nga tri pjesë: nga pjesa e të hyrave, pjesa e realizimit të buxhetit si dhe kontratat e lidhura deri më 01.09.2021. Të hyrat e rregullta për këtë periudhë kanë qenë 923,391 euro që ka një diferencë pozitive në raport me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar prej 121,249 euro, po ashtu kur i mbledhim edhe gjordat nga gjykatat dhe trafikut atëherë kemi në total prej 1,005 euro dhe nëse bëjmë krahasimin me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar atëherë është një ndryshim pozitiv në total prej 61,556 euro. Kështu që sa për informatë deri më datën e sodit, ende nuk kemi inkasim të hyrave të gjordat dhe ky problem nuk është vetëm në komunën tonë por të gjitha komunat e republikës së Kosovës dhe kemi bërë kërkesën kështu që jemi në pritje të raportit të të hyrave dhe shpresoj se nuk do të vonohen dhe do të kemi edhe ato të dhëna. Ndërsa realizimi i buxhetit në total është prej 10,944 që në përqindje i bën 70,62%, pastaj kemi edhe pjesën e shpenzimeve komunalë si dhe pjesa e tretë janë raportet mbi kontratat e lidhura deri më 30.09.2021. Pra unë nuk do ju marr me shumë kohë, kështu që hapësira është e juaja nëse eventalisht keni ndonjë pyetje.

Rasim Fazliu – Përshëndetje për ju kryesues, nënkryetarin, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, drejtorët e drejtorive, përfaqësues të mediave dhe gjithë ju të pranishëm. E falënderojmë drejtorin për paraqitjen e raportit financiar për periudhën Janar-Shtator 2021. Unë e kam lexuar raportin me vëmendje dhe të them të drejtën sa i përket të hyrave të planifikuara sepse realizimi është bo i madh se sa është bërë planifikimi, kështu që është bërë një punë e mirë këtu. Pastaj të hyrat nga gjordat dhe gjykatat në krahasim me

vitin 2020 nuk janë te paraqitur te gjitha por megjithatë ka rritje ne bazë te shifrave që i kemi këtu. Nëse shkojmë ne faqe 5, krahasimi i hyrave te realizuara sipas kodeve ekonomike 2021-2020, që kisha me i ngritë disa çështje këtu, si për taksa rrugore për vitin 2021 planifikimi ka qenë 135,000 euro ndërsa realizimi është bërë 254,000 euro d.m.th. është një realizim shume me i madhe se sa është planifikuar, pra kjo është mirë që ka ndodhur por do te ishte mirë me na dhanë sqarime se pse është bërë planifikimi i vogël kurse realizimi është bërë shume i madh. Pastaj kemi taksa për certifikata tjera, që kanë qenë te planifikuara 18,000 që edhe këtu ka ngritje prej 41,138, pastaj taksat për legalizim te objekteve ku planifikimi ka qenë 28,000 euro ndërsa këtu kemi rënie pasi nuk është realizuar as afërsisht për sa është planifikuar. Po ashtu kemi edhe participimin ne bujqësi, ku janë te parashikuar 80,000 euro ndërsa edhe këtu është realizuar mbi 50% rreth 45,000 euro dhe sigurisht se ka ndonjë përgjigje rreth kësaj nga drejtori. Pastaj tek tatimi ne pronë qëndron mirë puna sepse ka rritje te hyrave ne krahasim me vitin paraprak. Tej shpenzimet sipas kategorive ekonomike shohim se shpenzimi i buxhetit neper kategori, nuk e di arsyen mirëpo nuk është i kënaqshëm dhe nëse e shohim që alokimi i mjeteve ka qenë por realizimi i shpenzimit te këtij buxheti ka qenë me i vogël mirëpo unë nuk dyshoj pasi qdo her buxheti tradicionalisht është shpenzuar mbi 98% dhe kjo është praktikë e mëhershme. Pastaj shëndetësisia dhe mirëqenia sociale, shpenzime kanë 208,139 ne vitin 2020 ndërsa ne vitin 2021 janë 340,321 pastaj kemi edhe ne arsim 148,774 për vitin 2020 ndërsa për vitin 2021 kemi një rrije prej 174,121 euro, që edhe këtu kërkoj sqarime. Pastaj kemi kodin 13133 shpenzimet tjera te udhëtimit zyrtar brenda vendit që ne vitin 2020 kanë qenë 8555 euro kurse tash i kemi 23,778 euro që do te thotë se është një dallim shume i madhe krahasuar me vitin 2020 rreth shpenzimeve tjera te udhëtimit zyrtar brenda vendit. Po ashtu kemi edhe kode tjera, tek shërbimet komunal gjithashtu kemi ndryshime pasi ka rritje te shpenzimeve që për vitin 2020 kanë qenë 114,000 ndërsa per vitin 2021 janë 150,000 dhe gjithashtu krejt ne fund dua te di si po shkon puna e realizimit te projekteve që janë ne vazhdimësi, a janë ne ritmin e paraparë.

Fehmi Cena – Përshëndetje për ju kryesues, anëtarët e KPF-së e posaçërisht kolegun bacën Rasim për shkak te gjendjes shëndetësore dhe me vjen mirë që ka dal tash ne punë. Fillimisht e falënderoj drejtorin e Financave për përgatitjen e raportit financiar Janar-Shtator 2021, mendoj se është një raport gjithëpërfshirës dhe i qartë. Tek pjesa e te hyrave për këtë periudhë 9-mujore për këtë vite, siç e tha edhe drejtori po shihet se ka bilanc pozitiv ne raport me vitin paraprak 2020 dhe gjithashtu tek tabela 1.2 shohim se ka një rritje te hyrave dhe bilanc pozitiv edhe ne raport me planifikimin. Tani e dua një sqarim këtu tek tabela 1.2 tek shtylla e 5, ku thotë krahasim realizimi planifikimi 2021, që janë disa shifra që për mua nuk janë te qarta dhe nëse e krahasojmë ne një mënyrë sipas muajve do te thotë për janar atëherë planifikimi realizimit është se për janar ka pasur te hyra me pak se sa planifikimi. Pastaj tek faqe 5 te tabela 1.5 krahasimi i te hyrave te realizuara sipas kodeve ekonomike 2020-2021. Tash ne krahasimin e par po shihet që është I mire ne krahasim me planifikimin mirëpo ashtu siç e tha edhe parafolësi Rasim Fazliu që ka një diskrepancë ne disa kode, pasi po flasim per diskrepanca te mëdha ne mes te planifikimit dhe realizimit, si e ceki ne fillim taksa rrugore është një diskrepancë shume e madhe por janë edhe shume te tjera që tani nuk do ti përmendi pasi I përmendi me herët Rasim dhe sigurisht se drejtori do te jep sqarime. Pra është ajo që ne e kemi thënë edhe me përpara, te planifikimi drejtorit përkatëse duhet te jenë me te sakta ne planifikim që me qenë me afër realizimit. Pastaj te faqja 7, tek tabela 3.1 gjithashtu dua një sqarim shpenzimet sipas programeve te drejtorive, tash tek shpenzimet kapitale si administrata e arsimit shpenzimet kapitale 406,373 euro gjithashtu përfund i keni nen programet para fillor, fillor, i mesëm dhe shpenzimet kapitale a nuk do te ishte më mirë te renditen tek nën programet konkrete ku është shpenzuar, pasi nëse është ndërtuar një shkolle fillore atëherë te programi fillore. Pra administrata e arsimit po ngjan sikur administrata i ka shpenzimet e veta administrative, pra besoj se jam i qartë rreth kësaj dhe kërkoj sqarim për këtë. Tek shpenzimet mallra dhe shërbime sipas kodeve ekonomike faqe 12, tabela 3.4, që janë disa kode që kërkojnë sqarime si kodi 13460 shërbime kontraktuese tjera, shpenzimet kanë qenë për këtë periudhë kohore mbi 390,000, pra kërkoj sqarim se qka hynë ne këto shërbime kontraktuese tjera sepse është një shume goxha e madhe që është shpenzuar, pastaj e njëjta faqe te kodi i parafundit 13640 furnizim pastrimi, pra edhe këtu kemi një shpenzim për këtë periudhë kohore mbi 35,000 dhe me bie ne sy krahasimi me vitin e kaluar ka qenë mbi 3000 kurse sivjet për periudhën e njëjtë mbi 35,000 që është një shpenzim enorm nëse e krahasojmë me periudhën e njëjtë te vitit te kaluar dhe sigurisht se kërkojmë sqarim për këtë. Po ashtu te prokurimi gjithashtu kërkojmë sqarime,

pastaj te shërbimet konsulentë individuale për nevojat e komunës së Rahovecit, që bie në sy se këto shërbime konsulentë sipas meje janë në numër shumë të madhe e sidomos nëse shikojmë drejtorinë për kulturë rini dhe sport që gjithsej janë 7 shërbime konsulentë. Kështu që po del se kjo drejtori me shumë funksionon përmes drejtorive konsulentë se sa punëtorëve që i ka vet ajo drejtori. Pra nëse drejtoria ka nevojë për aq shumë shërbime konsulentë atëherë ndoshta me mirë është me u hap konkursi edhe me pas punëtor te përhershëm në atë drejtori që merren me ato shërbime, por megjithatë është një pjesë e buxhetit që duhet me u buxhetue veç për çdo vit. Pra tash kjo është pjesë e prokurimit, po me intereson se a janë këto shërbime konsulentë në kuadër të planit të zyrës së prokurimit apo janë jashtë zyrës së prokurimit d.m.th. punë shtesë apo aktivitete shtese, pasi në kemi parë se kur kemi shqyrtua edhe raportet e zyrës së prokurimit atëherë kemi parë se ka edhe mjaft punë shtesë që ata i bëjnë jashtë planit të punës që ka qenë edhe vërejtje e auditorit të jashtëm dhe kjo bie në sy në këtë rast dhe unë po mendoj se është pak e tepruar.

Dervish Çadraku – Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë jute pranishëm në sallë. Unë nuk po mendoj që me hie në detaje pasi parafolësit veçse e zbërthyen dhe bënë një analizë për gjithë materialin që na keni dërguar dhe punën që keni kryer aty, por unë tani kam vetëm disa pyetje të shkurtra që kërkojnë sqarim nga ana e drejtorit sepse nuk i kam të qarta për disa shpenzime që janë bërë, si në faqe 12 të kodi 13133 shpenzime tjera për udhëtime zyrtare brenda vendit 23,778 euro, kështu që kërkoj sqarim rreth këtij shpenzimi dhe gjithashtu shpenzimi për anëtarësim është shumë e paqartë për mua. Po ashtu në faqe 13, kemi një gabim të vogël dhe nuk besoj që keni ndonjë zyre për veprime komike, sepse këtu thotë furnizimi me preparate komike dhe duhet të përmirësohet dhe të bëhet kimike. Po ashtu në faqe 17 kam një vërejtje, furnizimi me flamuj, rekuizita për nevojat e komunës së Rahovecit me dy lote, ku loto e parë është 10,000 kurse loto e dytë 8940, ku gjithsej janë afër 19,000 euro dhe me sa e di unë është 1,50 cent është flamuri kombëtar dhe me këtë shumë mund të blihen rreth 15,000 flamuj. Kështu që nëse i shikojmë tani nuk janë të ndërruar askund e sidomos në vendet e të rënëve dhe përmendoret e dëshmorëve i keni flamurët e grisur, ku vërtet është mëkat të shihen ashtu. Pra nëse i blejmë këta flamuj që me siguri blihen edhe gjëra tjera atëherë të paktën të ndërrohen nëpër ditët e caktuara dhe datat që në i respektojmë dhe i shënojmë dhe porosia ime është që kjo punë të kryhet nga komuna pasi bizneset private nuk i ndërrojnë, kështu që porosia ime është të ndërrohen këta flamuj dhe të respektojmë këto vende pasi nga gjaku i këtyre të rënëve kemi ardh në këtë kuvend dhe në këto institucione, kështu që kemi për obligim të mbrojmë emblemën dhe shenjë të tyre.

Afrim Limani – Faleminderit për pyetjet, në pyetjen e parashtruar nga Rasim Fazliu për taksë rugore, pasi ka një diferencë të madhe këtë vit në krahasim me vitin e kaluar dhe të gjithë e dimë se vitin e kaluar kemi qenë në pandemi dhe realisht një numër madhë i veturave nuk janë regjistruar dhe kjo drejtpërdrejt ka ndikuar të ky ndryshim i madh i inkasimit të të hyrave. Po ashtu raporti nuk e paraqet gjendjen reale të ngjarjeve që janë zhvilluar deri me tani sepse në këtë e paraqesim vetëm raportin shpenzues, pasi ka raste që është bërë një shpenzimi bëhet muajin e ardhshëm ndërsa fatura na ka ardh këtë muaj, pra edhe këtu është dallimi. Po ashtu taksa për legalizime në raport me vitin e kaluar në raport me planifikim ka diferencë të madhe dhe nëse ju kujtohet në seancën e parafundit në raportin 6 muaj ju pata thonë që këtu jam kemi huqur dhe tash po e pranoj, po ashtu taksa në participim në bujqësi edhe këtu ka dalim në planifikim sepse në raport me vitet e kaluara participimet apo të hyrat që janë zhvilluar në kuadër të participimit si bazë ka qenë ai i inkasimit dhe realisht këtë vit nuk ka pasur participim në raport me vitin e kaluar me shumë dhe kjo është e dukshme si p.sh. në këtë vit nuk kemi bërë thirrje për serra për aplikim dhe kjo ka ndikuar në ndryshimin e atij raporti. Pastaj të shpenzimi i buxhetit konsideroj se shpenzimi deri në shtator është i mirë pasi është shpenzuar mbi 70% dhe deri në fund do të ketë periudhë të mirë të raportit dhe përqindja është e lartë e shpenzimit të buxhetit dhe deri në fund të vitit nuk besoj që do të kemi problem pasi trendi i shpenzimit është duke shkuar në mënyrën e duhur dhe të kënaqshme. Po ashtu shpenzimet e udhëtimit brenda vendit dhe kjo emërtohet ashtu si shpenzim në kuadër të kodeve ekonomike dhe që realisht lidhet drejtpërdrejt me bartjen e nxënësve, pra shpenzimet që bëhen për operatorët atëherë regjistrohen në kuadër të këtij kodi. Kështu që krahasimi me vitin paraprak është sepse në vitin 2020 ka qenë pandemi dhe shkollat nuk kanë punuar dhe këtë e dinë të gjithë dhe sigurisht se në nuk e kemi paguar operatorin deri sa nuk i ka bartur nxënësit dhe sigurisht se ky është dallimi. Pastaj të rritja e shpenzimeve komunalë që në krahasim me vitin e kaluar është me e madhe që sigurisht edhe kjo ndërlidhet me vitin e kaluar pasi shkollat nuk kanë

punuar pasi shpenzimin me te madhe e kanë shkollat dhe sigurisht se deri sa nuk kanë punuar edhe shpenzime nuk kemi pasur. Po ashtu një pyetje e parashtruar se si po ecën dinamika e realizimit të projekteve dhe me plot përgjegjësi ju them se deri me tani po shkon në mënyrë të mirë por përgjigjen me të mirë mund të ju jep drejtori i shërbimeve publike. Pastaj pyetja tjetër ishte sqarim për borgjet që ka komuna, realisht si drejtori e financave duke respektuar një udhëzim që ka ardhur këtë vit, vazhdimisht në baza mujore raportojmë në ministri për obligimet kontraktuale dhe obligimet financiare, kështu që obligimet kontraktuale kanë filluar këtë vit kurse financiare kanë ekzistuar edhe me herët dhe në baza mujore në raportojmë. Pra për muajin e fundit shpenzime financiare do të kemi mbi 500,000 euro mirëpo ky shpenzim muajin e ardhshëm mundet me ra sepse u alokue buxheti dhe në mundemi me i krye operatorët por eventualisht edhe mundet me u rrit por në fund të vitit afërsisht mundemi me pas një borgj ashtu sa ka qenë vitin e kaluar, ndoshta me se shumti rreth 2 milion. Po ashtu edhe me obligime kontraktuale qëndrojmë mirë, pasi kontratat që janë lidhur me bazë 3 vjeçare janë lidhur në bazë të një analize të mirë të buxhetit. Pastaj në pyetjen e parashtruar nga Fehmi Cena tek tabela 1 për mospërputhje të shifrave, te faqe 3 të realizimi dhe planifikimi 2020 dhe realizimi dhe planifikimi 2021 këto janë shumë të sakta dhe paraprakisht harrova qysh në fillim me ju kërkuar faljes pasi raporti shumë me vonësë na ka ardhur pasi deri jemi barazua me ministrin e financave dhe kemi bërë të pamundurën që të dorëzojmë me kohe dhe mund të ndodhë që kemi ndonjë gabim pasi nuk është i korrigjuar të krahasimi i realizimit planifikimit për vitin 2021 por sigurisht se për mbledhje të kuvendit do të përmirësohen këto, mirëpo ajo çka jam i sigurt se realizimi 2020 dhe planifikimi dhe realizimi 2021 janë shumë të sakta. Pastaj pyetje tjetër ishte po ashtu të taksa rrugore që raport me planifikim dhe realizim ashtu siç e dhashë me herët përgjigjen ka qenë vit pandemik dhe qytetaret nuk i kanë regjistruar makinat e tyre. Pyetje tjetër ishte edhe shpenzimet kontraktuale tjera për vlerën e lartë të tyre, ku në kuadër të këtij kodi hynë shpenzimet e Caritasit, ku vlera në total brenda vitit është afërsisht mbi 220,000 euro pastaj kemi shërbimet konsulentë afërsisht 90,000 euro dhe këto shpenzime janë futura në kuadër të këtij kodi. Mirëpo sa për informimin tuaj përpos këtyre shpenzimeve për me ju ikë keq klasifikimeve në kuadër të investimeve kapitale, shumë projekte regjistrohen në kuadër të këtij kodi, që mundemi me i përmend p.sh. dy projekte që janë në kuadër të drejtorisë për financa si rrënimi i objekteve pa leje dhe sinjalizimi horizontal dhe vertikal i rrugëve, pasi në e dimë që për me ju ikë keq klasifikimeve e kemi qit në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve dhe krejt këto shpenzim regjistrohen në kuadër të këtij kodi dhe për këtë arsye është vlerë e lartë. Kështu që për informata me të hollësishme nëse keni nevojë atëherë për mbledhje të kuvendit ju tregoj saktë se ku janë shpenzuar ato mjete. Të shpenzimet për anëtarësim, në e kemi një marrëveshje që jemi anëtar të agjencionit zhvillimor që janë pjesë i gjithë regjioni me seli në Prizren që paguajmë një anëtarësim brenda vitit me vlerë prej 5000 euro, pastaj është edhe asociacioni i komunave që në si komunë e kemi kuotën prej 8000-9000 euro dhe krejt këto shpenzime regjistrohen aty. Pra edhe për këtë kod në mbledhjen e kuvendit do ta kemi një raport me të detajuar dhe saktësisht se ku janë shpenzuar këto. Pastaj të shërbimet konsulentë të drejtorisë e kulturës rinis dhe sportit për shkak të numrit të madh, e di që kanë qenë të planifikuara në prokurim dhe arsyeja pse ka nevojë me shumë por këtë përgjigje me mirë mund të jep drejtorisë e kulturës, kështu që këtë pyetje mund ta para shtroni edhe në kuvend. Po ashtu edhe furnizimi me flamuj, në për çdo festë e kemi bërë ndërrimin e tyre dhe tash i kemi porosit, tani i kemi porosit mbi 200 flamuj pasi qysh në festën tjetër mbi 50% të tyre duhet me i ndërrua pasi edhe dëmtohen mirëpo ky është një problem në vazhdimësi pasi është e pamundur me qëndrua brenda një viti, kështu që duhet me qenë edhe me të kujdesshëm për këtë dhe për festa të ardhshme të behet ndërrimi i tyre, pasi një gjë të tillë edhe kryetarin e komunës z. Smajl Latifi e preokupon ky problem vazhdimisht.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor për të gjitha sqarimet, atëherë meqë nuk kemi tjerë të lajmëruar konstatoj se kalon për kuvend edhe pika e dytë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Informatë për menaxhimin e mbeturinave për vitin 2021.

Bjondina Rama – Përshëndetje për të gjithë. Do të mundohem të flas shkurt për këtë informatë për gjendjen në komunën e Rahovecit rreth menaxhimit të mbeturinave për vitin 2021. Para se të fillojmë me raportin, do të ishte mirë të cekim se në si komunë jemi në bashkëpunim me agjencionin japonez për bashkim ndërkombëtar që është një projekt 3 vjeçar për ngritjen e kapacitetit dhe drejt një shoqërie të shëndoshë ku jemi si faze e dytë 4 komuna të Kosovës siç është Suhareka Malisheve Rahoveci ku jemi duke punuar

vazhdimisht ne te gjitha fazat te përgatitjes që te kemi një ambient sa me te pastër dhe te mos kemi te krijume deponi ilegale. Pra para vetes e keni raportin, sa i përket komunës për vitin 2021 është bërë mjaft dhe sigurisht se ka nevojë ende pasi mjedisi është një temë e gjërë dhe gjithmonë kohë pas kohe ne i largojmë deponitë ilegale por përsëri krijohen por besoj që jemi ne rrugë te mirë dhe që nga viti 2018,2019,2020 komuna e Rahovecit shpallet si komuna që fiton grante për mjedis te pastër dhe marrim çmime sa i përket mjedisit, kështu që te gjitha i keni ne raport dhe nëse keni ndonjë pyetje do te jem këtu për me ju dhanë përgjigje. U mundova që ne pika te shkurta me ju paraqit, pasi ne aspektin financiar ishte me rëndësishme dhe këtu është vetëm si informatë se si qëndron gjendja, por sigurisht se jemi duke punuar vazhdimisht dhe jemi shume te lumtur sepse me agjencionin japonez jemi duke detajuar çdo fazë edhe deponitë ilegale edhe opinionin publik dhe gjithçka është duke shkuar sipas planit dhe ky projekt do te jet 3 vjeqar dhe gjithashtu mendoj se jemi me fat që jemi pjesë e këtij projekti dhe do te kemi mundësi që mjedisi do te rregullohet kohë pas kohe.

Dervish Çadraku – Me te vërtet me bëri përshtypje kur tha se kemi marr shpërblim për mjedis te pastër, kur e dimë që veç ne Malësi te Vogël me ardhe dhe me pae sa shumë mbeturina ka rreth shtratit te lumit Drini i Bardh dhe nuk e di se si ka ardh ky vlerësim pasi unë mendoj se mbeturina ka ne te gjitha anët dhe për këtë nuk e lë fajtor vetëm komunën pasi edhe ne qytetaret e mbajmë barrën e përgjegjësisë për këtë mirëpo megjithatë nuk e kemi punën mire me ambientin pasi kemi shume mbeturina dhe këtë e shoh ne Malësi te Vogël që përpos ka Drini i Bardh e shoh që edhe ka malet hudhen mbeturina. Pra është një katastrofë ekologjike ne komunën tonë pa deshtë me ngarkua dikën me përgjegjësi pasi kjo tek e fundit është përgjegjësi e te gjithë neve por megjithatë komuna I ka disa mekanizma që me i ndalua këto veprime dhe me i ndëshkua që ne si privat nuk kemi mundësi me bërë një gjë te tillë. Prandaj nuk ka vend për vetëkënaqësi por duhet te punojmë që te krijojmë mjedis te pastër pasi nuk e kemi mjedisin e pastër.

Fehmi Cena – Përshëndetje për te gjithë. E falënderoj zyrtaren për prezantimin e kësaj informate dhe nëse e bëjmë krahasimin se si ka qenë ambienti dhe si është tash, sigurisht se është më mire mirëpo përsëri vlen për tu dëshiruar e sidomos te qeverisjes lokale siç e ceku pasi edhe pse mbeturinat po largohen ato prape po krijohen mirpo duhet te bëhet përpjekje me e madhe dhe e gjithanshme që jo vetem te punohet ne pastrimin e deponive por te punohet edhe ne edukatën qytetare që te mos hudhen mbeturina vend e pa vend dhe gjithashtu komuna te krijoj me shume vende dhe nëse kjo çështje është ne proces por e dua një sqarim ne faqe 3, sfidat ne menaxhimin e mbeturinave dhe ceket mbeturinat mirëpo nuk e ceket se cilat lloje te mbeturinave që behet fjalë për mbeturina medicinale, shtazore. Për këto medicinale, komuna ka një marrëveshje për evitimin e tyre dhe nga kjo që po shoh unë nuk është menaxhimi adekuat dhe ndoshta është me dobët se sa që ka qenë ne te kaluarën, pasi ne te kaluarën Rahoveci e ka pasur një aparat që ka bërë asgjësimin e këtyre mbeturinave mirëpo ka vite që Rahoveci nuk më një aparat te tillë për asgjësimin e mbeturinave kështu që do te ishte mirë që ai aparat te blihet apo te kërkohet si donacion Po ashtu aty thuhet se komuna e Rahovecit nuk kemi mbeturina kimike, por unë mendoj se mbeturina kimike siç janë p.sh. serviset e kerreve që lirojnë mbeturina mjaft të dëmshme që bëjnë një ndotje te madhe te ujërave sipërfaqësore si lumenjtë dhe po ashtu edhe podrumet për përpunimin e rrushit verës rakisë që realisht krijojnë mbeturina kimike. Pra edhe ne atë drejtim duhet te punohet për eliminimin e tyre dhe kjo për mua është shqetësuese nëse thuhet se nuk ka mbeturina kimike atëherë duhet te merren veprime kundër tyre dhe duhet te punohet edhe ne atë drejtim.

Bjondina Rama - Është shume e vërtet për fshatin Malësi e Vogël pasi kohë pas kohe mbeturinat por problemi është se edhe aty pranë Drinit te Bardh i kemi largua dhe gjithashtu edhe ne pjesë te ndryshme i kemi larguar pasi i kemi edhe te dokumentuara me foto mirëpo përsëri ato po krijohen. Si e ceka edhe me herët ne bashkëpunim me agjencionin kemi kriju plot projekte që disa pjesë jo vetëm ne Rahovec që është një pjesë për konstruktim demolim me u vendos mbeturinat por me ju krijua mundësi qytetareve që edhe ne pjesën e juaj me pas një vend te caktuar me i hudhë mbeturinat e jo me i hudhë vend e pa vend pasi ne njëfarë mënyrë qytetaret nuk janë fajtor pasi nëse ju krijon kushte sigurisht se do te gjejnë vende jo te përshtatshme për hudhjen e mbeturinave. Gjithashtu kjo dukuri ne nivel te Kosovës e ne veçanti për qytetin e Rahovecit, është e vërtet se kemi deponi te mbeturinave por jo siç kanë qenë dhe jo siç është ne nivel te Kosovës. Kështu që ne si kuvend komunal japim përgjegjësi vetëm për deponit që krijohen ne hapësirat

publike shtetërore, mirpo këtu ka që janë edhe private, pra nuk mundemi me shkue edhe me ju largue neper parcelat e tyre dhe ne kemi biseduar edhe me agjencionin kur kemi dal me bo hulumtimin psh e kemi një pamje ka pjesa e Brestofcit me siguri e keni parë që është krijuar një deponi nga konstruktimi por ne njëfarë mënyrë nuk jemi përgjegjës përveç se me inspektua dhe me dënua pasi ne nuk mundemi me shkua edhe me pastrua atë vend pasi është pronë private por inspektorati e kryen punën e vet ne mënyrën si është nevoja dhe duke marr parasysh si është gjendja ne përgjithësi ne Kosovë është duke u punuar vazhdimisht por gjithmonë ka nevojë pasi si shtet ende jemi ne fazën e vetëdijesimit që realisht është i ulët duke filluar nga fëmijët e deri tek te rriturit dhe me plot te drejtë ju themi se me shume kuptojnë fëmijët sa i përket vetëdijesimit te hudhjes se mbeturinave se sa te rriturit. Pra nëse nuk e mbrojmë vendin tonë, sigurisht edhe një komunë ska çfarë të bëj sepse ka shume pak inspektorat por duke marr parasysh se qysh nga muaji Mars kemi larguar shume deponi por që tani janë shtuar me shume dhjetë për një periudhë shume te shkurtë edhe pse vazhdimisht i largojmë. Por jemi ne proces te mirë edhe raportimi apo fitimi që kemi marr nga Gizi gjerman nuk është vetëm për deponi por shtrirja e menaxhimit d.m.th. shtrirja e te gjitha kompanive dhe prej te gjitha atyre mbeturinave që janë krijuar nuk ka mbeturina te amvisërisë shume pasi me shume janë konstruktim demolim dhe mbeturina te forta dhe kjo është një e mirë por kohe pas kohe jemi duke punuar gjithmonë ne bashkëpunim me drejtorin e shërbimeve publike po punojmë vazhdimisht dhe kemi gjithë gjendjen aktuale pasi i kemi te gjitha edhe te dokumentuara edhe me foto se si janë largue dhe si po krijohen dhe falë bashkëpunimit edhe janë fitue grantet pasi i kemi plotësuar kriteret duke u bazuar ne anën ligjore dhe anën praktike kur i kemi dy kompani dhe shtrirja është e përgjithshme përveq që nuk është zgjedhur ende problemi për konstruktim demolim. Dhe ne jemi ne vazhdim te fazave ku i kemi pilot projektet prezentë edhe për deponite ilegale që krijohen edhe për lesiciatore që e ceku me herët Fehmi Cena pasi ne Prizren është një leciatore që i dërgojmë atje por do te ishte mirë edhe komuna e Rahovecit që mos me shkue atje dhe mos me pas mbeturina medicinale. Sa i përket ndotësve kimik, është e vërtet që ka ndotje kimike por jo edhe ne mase te madhe që do te ishte problem madhor, përveç podrumëve që ka raste që ndotësit e ujërave ka një teme te veçantë që merret me analiza dhe i sheh se deri ku ka mbërri por problemi është se edhe ndotësit edhe podrumet shkojnë derdhen ne lumin Drini i Bardh dhe ky është një problem madhor dhe nuk mundet vetëm një komunë e vogël me zgjidh këtë problem dhe ne momentin kur zgjidhet trajtimi i ujërave te zeza atëherë përfshihen edhe elementet kimike edhe te gjitha e kanë rrugën e duhur aty ku është vendi. Pastaj pyetja tjetër ishte sa i përket mbështetja e donatoreve, problemi është te Gizi pasi kanë kontraktim me ambasadën gjermane dhe te prokurimi ka kaluar procedura por ju ka kthye përsëri për shkak te ankesave edhe po ka vonesa jo vetëm për komunën tonë por ne përgjithësi, kështu që ata mjete po na japin mirëpo ka komunë që nuk i ka marr as te viti 2018 dhe ne vetëm për vitin 2018 i kemi marr kontejnerët që janë afër 2000 kontejnerë me kapacitet 120 litra dhe 120 kontejner me kapacitet 1.1, pasi këto janë me shume 4-5 organizata që janë te lidhura bashkërisht për kryerjen e këtyre punëve por sigurisht se ka nevojë për përmirësime dhe ne e dimë ku jemi por me krahasua me vitet e kaluara besoj që është duke u punuar edhe sigurisht se po i jepet një rëndësi me e veçantë.

Kryesuesi – Faleminderit shume zonja Rama për sqarimin, atëherë meqë nuk kemi tjerë te lajmëruar, kalojmë në pikën e katërt te rendit te ditës:

4. Të ndryshme.

Të nderuar anëtarë te Komitetit për Politikë dhe Financa, faleminderit te gjithëve për kontributin e dhënë, shihemi ne mbledhjen e radhës.

Mbledhja përfundoj 11:00

Procesmbajtësi,

Agim Hoti



KRYESUESI

Afrim Dina